**SYLLABUS i Lëndës**

| Të dhënat bazike të lëndës | |
|---|---|
| **Njësia akademike:** | **Fakulteti i Arkitekturës** |
| **Titulli i lëndës:** | **Projektim 1 – Banim Individual** |
| **Niveli:** | **Bachelor** |
| **Statusi i lëndës:** | **Obligative** |
| **Numri i orëve në javë:** | **2+2** |
| **Vlera në kredi – ECTS:** | **6 ECTS** |
| **Koha / lokacioni:** | **Sipas orarit** |
| **Mësimëdhënësi i lëndës:** | **Prof. Ass. Dr. Miranda Rashani** |
| **Kontakti:** | **miranda.rashani@uni-pr.edu** |
| **Orari i konsultimeve dhe detaje tjera:** | Fakulteti i Arkitekturës, Kati II, K05<br>Inkurajohen studentët të caktojnë takime për konsultime me mësimdhënësin.<br>Ju lutem kontaktoni në: miranda.rashani@uni-pr.edu |
| **Njohuritë paraprake/kërkesat** | Të drejtë për të vijuar këtë lëndë kanë studentët të cilëve detyrat semestrale të punuara në lëndën Bazat e Projektimit 2 u janë vlerësuar me notë pozitive, si dhe të cilët kanë të regjistruar semestrin në vitin akademik përkatës. |
| | |
| **Përshkrimi i lëndës** | Projektimi arkitektonik, organizimi hapësinor dhe teknologjia e ndërtesave të banimit individual. |
| **Qëllimet e lëndës:** | Qëllimi i kursit është njoftimi i studentëve me projektet dhe projektimin, si dhe për tipologjitë, organizimin hapësinor dhe teknologjinë e ndërtimit të ndërtesave të banimit individual. |
| **Rezultatet e pritura të mësimit:** | Pas përfundimit të këtij kursi, ndër të tjera, studentët do të arrijnë këto aftësi:<br>• Do të kenë njohuri mbi ndërtesat e banimit individual në përgjithësi dhe tipologjitë e shtëpive në veçanti,<br>• Do të kenë njohuri mbi projektimin e ndërtesave të banimit individual,<br>• Do të jenë të aftë që të shqyrtojnë dhe analizojnë komponentët arkitektural në vepra arkitekturale të tjera si parakusht për nisjen e veprimtarisë vetanake,<br>• Të kuptojnë problematikën e organizimit themelor funksional të hapësirave të dedikuara për banim te objektet e banimit individual,<br>• Zbatojnë njohuritë e fituara në shembuj konkret dhe në praktikë. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | |
| **Kontributi në ngarkesën e studentit**<br>**(gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)** | | | |
| **Aktiviteti** | **Orë** | **Ditë/javë** | **Gjithsej** |
| | | | |
| Ligjëratat | 2 | 15 | 30 |
| Punë në laborator/Ushtrime | 2 | 15 | 30 |
| Përgatitje për test intermediar | 2 | 14 | 28 |
| Konsultimet me mësimdhënësin | 1 | 10 | 10 |
| Puna në terren | 2 | 1 | 2 |
| Testi, punimi seminarik | 1 | 3 | 3 |
| Detyrë shtëpie | 2 | 10 | 20 |
| Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi) | 1.5 | 10 | 15 |
| Përgaditja për provim final | 2 | 4 | 8 |
| Projektet, prezantimet, etj. | 1 | 5 | 5 |
| **Totali** | | | **151** |
| | | | |
| **Metodologjia e mësimdhënies:** | Lënda do të zhvillohet në mënyrë interaktive, duke i kushtuar rëndësi të veçantë diskutimit dhe elaborimit të shembujve praktik në lidhje me temat përkatëse.<br>Lënda do te përfshijë ligjërata dhe ushtrime. | | |
| **Metodat e vlerësimit:** | **Vlerësimi i detyrave semestrale: 40%**<br>**Aktiviteti: 10%**<br>Detyrat semestrale + aktiviteti = 50%<br>……………………………………………………………<br>**Vlerësimet e ndërmjetme teorike: 20% (2*10%)**<br>**Vlerësimet e ndërmjetme vizatim: 30%**<br>Ose<br>**Vlerësimi i provimit final: 50%** (pjesa 1 - 30%, pjesa 2 – 20%)<br><br>Sistemi i vlerësimit: | | |

| Përqindja | 10 | 9 | 8 | 7 | 6 | 5 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 50% Cilësi | | | | | | |
| 20% Origjinalitet | | | | | | |
| 10% | | | | | | |

| Sasi | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 20% Gramatikë/ grafikë | | | | | | |

95 -100%=10
85 - 94% = 9
75 - 84% = 8
65 - 74% = 7
55 - 64% = 6
00 - 54% = 5 nuk kalon (përsëritë lëndën)

**Literatura**

**Literatura bazë:**


1. De Chiara J, Panero J, Zelnik M (1995). *Time-saver standards for housing and residential development*. New York: McGraw-Hill.
2. Pfeifer G, Brauneck P (2015). *Residential Buildings: A Typology*. Birkhäuser.
3. Littlefield D (2012). *Metric handbook: planning and design data.* Amsterdam:Elsevier/Architectural Press.
4. Neufert E, Neufert P, Kister J (2012). *Architects' Data*. Chichester, West Sussex, UK: Wiley-Blackwell.
5. Tait J (2018). *The Architectural Concept Book*. Thames and Hudson.


**Literatura shtesë:**


6. Bachelard G (1969). *The Poetics of Space*. Boston: Beacon Press.
7. Bell J, Stathaki E (2018). *The contemporary house*. Thames & Hudson Ltd.
8. Bradbury D, Powers R (2018). *The Iconic House (Architectural Masterworks Since 1900).* Thames & Hudson; Illustrated Edition.
9. Heckmann O, Schneider F (2012). *Floor Plan Manual: Housing*. Birkhäuser.
10. Jodidio Ph (2020). *100 Contemporary Houses*.Taschen GmbH, 2020.
11. Klaus-Peter G (2005). *Living plans (new concepts for advanced living)*. Birkhauser.
12. Malek E (2017). Simple introduction to architecture.
13. Pressman A (2007). *Architectural Graphic Standards*. Hoboken, N.J.: John Wiley & Sons.


**Plani i dizajnuar i mësimit:**

| **Java** | **Ligjërata që do të zhvillohet** |
|---|---|
| ***Java e parë:*** | Hyrje – diskutim i përgjithshëm rreth përmbajtjes së lëndës dhe syllabusit<br>*Ushtrim 2 javor* |
| ***Java e dytë:*** | Metodologjia, koncepti dhe fazat e projektimit te objekteve të banimit – paraprojekti<br>*Ushtrim 2 javor - prezantim* |

| | |
|---|---|
| ***Java e tretë:*** | Metodologjia, koncepti dhe fazat e projektimit te objekteve të banimit – projekti konceptual dhe skematik<br>*Test 1 – teorik*<br>*Ushtrim metodik* |
| ***Java e katërt:*** | Tipet e ndërtesave të banimit individual – koncepti urbanistik<br>*Detyra - konsultime* |
| ***Java e pestë:*** | Tipet e ndërtesave të banimit individual – Shtëpitë e veçuara<br>*Detyra - konsultime* |
| ***Java e gjashtë:*** | Shtëpitë dyshe<br>*Detyra – dorëzim faza 1* |
| ***Java e shtatë:*** | Shtëpitë dyshe<br>*Detyra - konsultime* |
| ***Java e tetë:*** | Shtëpitë  ne varg<br>*Detyra - konsultime* |
| ***Java e nëntë:*** | Shtëpitë  ne varg<br>*Detyra - konsultime* |
| ***Java e dhjetë:*** | Shtëpitë e kombinuara dhe me atrium<br>*Detyra - konsultime* |
| ***Java e njëmbëdhjetë:*** | Shtëpitë me atrium<br>*Test 2 – teorik*<br>*Detyra – konsultime* |
| ***Java e dymbëdhjetë:*** | Tipe të tjera të shtëpive<br>*Detyra – dorëzim faza 2* |
| ***Java e trembëdhjetë:*** | Analizë e funksionit dhe organizimit të banesës (shtëpisë)  - shembuj<br>*Test 3 – Vizatim*<br>*Detyra – konsultime* |
| ***Java e katërmbëdhjetë:*** | Analizë e funksionit dhe organizimit të banesës (shtëpisë) – projektim gjithëpërfshirës<br>*Detyra – konsultime* |
| ***Java e pesëmbëdhjetë:*** | Përmbyllje<br>*Detyra – dorëzim përfundimtar dhe prezantim* |
| | |

**Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

Çdo student duhet t`u përmbahet rregullave, kodit të mirësjelljes dhe politikave të UP-së.

**Mirësjellja:**

- Korrektësia në kohë dhe mirësjellje gjatë mësimit.
- Vijimi i rregullt i mësimit.
- Studenti nuk ka të drejtë të bëjë më shumë se 3 mungesa të arsyeshme ose të paarsyeshme në ligjerata ose në ushtrime.
- Mospërdorimi i telefonave celularë gjatë mësimit.
- Hyrja në sallë me kohë dhe të përgatitur me material të nevojshëm.
- Nxitet bashkëpunimi dhe origjinaliteti.

**Detyrat dhe provimet:**

- Dorëzimi i detyrave bëhet sipas orarit të caktuar për dorëzim. Në të kundërtën, vlerësohen me 0 pikë dhe studenti humbet të drejtën për të vazhduar më tutje syllabusin në semestrin përkatës.
- Plagjiatet janë rreptësisht të ndaluara. Punimet plagjiat dërgohen në komisionin disiplinor të UP-së.

**Të tjera:**

- Studentët janë të inkurajuar të kontaktojnë mësimdhënësit në rast të nevojave specifike apo të veçanta.